



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi
Sekretariati për vetëqeverisje lokale
Sekretarijat za lokalnu samoupravu
Nr./Br. 04-610/23- 7223/1



Në bazë të nenit 26 të Vendimit mbi financimin e sportit, ("Fletorja zyrtare e MZ -dispozitat komunale", nr. 032/19, 019/21), dhe nenit 3-7 të Rregullores mbi kriteret për ndarjen e mirënjohjes vjetore nga fusha e sportit numër 01-031/21-14079 prej më 15.11.2021, Sekretariati për vetëqeverisje lokale i komunës së Tuzit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për ndarjen e mirënjohjeve vjetore nga fusha e sportit për vitin 2023

Ftohen organizatat sportive - klubet sportive, shoqëritë sportive, shoqëritë sportive-rekreative, organizatat sportive të personave me aftësi të kufizuara, të regjistruara në Komunën e Tuzit në pajtim me Ligjin për Sport të Malit të Zi, të paraqesin propozimet e tyre të arsyetuara për ndarjen e mirënjohjeve vjetore nga fusha e sportit për vitin 2023, në këto kategori:

1. Sportisti më i mirë
2. Sportistja më e mirë
3. Ekipi sportiv i vitit
4. Punëtori sportiv i vitit

Për mirënjohje mund të jenë të propozuar sportistët, punëtorët e sportit që kryejnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Tuzit, si dhe organizatat sportive me seli në territorin e Komunës së Tuzit dhe që kanë arritur rezultate të dukshme në vitin për të cilin ndahet mirënjohja.

Së bashku me propozimet për dhënien e mirënjohjeve vjetore në fushën e sportit, organizatat sportive janë të obliguara që të paraqesin rezultatet e arritura sportive të vërtetuara nga Federata kompetente e sportit dhe organizatës sportive. Propozimet dorëzohen në formë të shkruar në arkivin e komunës së Tuzit, Sekretariatit për vetëqeverisje lokale me shënimin "Komisionit për ndarjen e mirënjohjeve vjetore nga fusha e sportit për vitin 2023" në afat prej 20 ditësh nga dita e shpalljes së thirrjes publike.

Formulari i cili është pjesë përbërëse e thirrjes publike mund të merret në faqen e internetit të Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me si dhe drejtpërsëdrejti në arkivin e komunës së Tuzit.

Formularët jo të plotë dhe të dorëzuar jashtë afati nga ana e organizatave sportive, e të cilat nuk kanë të bëjnë me rezultatet e tyre, Komisioni për ndarjen e mirënjohjes vjetore nga fusha e sportit, nuk do t'i shqyrtojë.

Komuna e Tuzit

Sekretariati për vetëqeverisje lokale

SEKRETARE,
Marina Ujkaj

